



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 166, datë 28.05.2020

PËR
PEZULLIMIN E PROCEDURAVE TË LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË
DHE EMËRIMIT LIDHUR ME PUNONJËSIT E GJYKATAVE, STATUSI I TË CILËVE
RREGULLOHET NGA LIGJI NR.98/2016 “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT
GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 90 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 54, 57, 85 të ligjit nr.98 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I :

1. Të pezullojë procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse nga Këshilli.
2. Ky vendim t’i njoftohet të gjitha gjykatave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR